



RAPORT MONITORIMI  
Gusht-Tetor 2021



# Pasuria Arkeologjike/ Kulturore & Siguria



**BUTRINT 2021**



AUTOR  
**Erisa Kryeziu**



[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)

*Shqipëria gëzon pasuri të larmishme të kulturës dhe trashëgimisë, të cilat tregojnë shumë për mënyrën se si ka jetuar dhe është zhvilluar shoqëria jonë. Kjo e shfaqur përmes vlerave, traditave, besimeve dhe identitetit tonë. Pasuri të tilla janë ruajtur brez pas brez ashtu sikurse insitucionalisht duke i qëndruar kohës dhe faktorëve natyrorë. Pasuri të tilla gjenden të ruajtura dhe të prezantuara përmes muzeve dhe parqeve arkeologjike të shtrira në të gjithë gjerësinë gjeografike të Shqipërisë.*

Zhvillimet e ndodhura në dy vitet e fundit kanë dominuar mënyrën e jetesës e si rrjedhojë edhe artin, kulturën dhe trashëgiminë. Pandemia e shkaktuar nga virusi COVID-19 paralizoi për një kohë të gjatë aktivitetet shoqërore e kulturore. Masat e marra për të parandaluar përhapjen e COVID-19 bënë që arti dhe kultura të kalonin në plan të fundit përballë nevojës për të siguruar shëndetin dhe më tej ekonominë familjare, si dhe pamundësia për të punuar në kushte normale.


Parë në këtë prizëm, shumë shfaqje artistike e kulturore u anuluan, shumë të tjera u transferuan nga një mjedis fizik në atë online, duke pamundësuar në këtë formë kontaktin fizik të individit me artistin dhe artin. Si rrjedhojë edhe kontakti me trashëgiminë kulturore dhe materiale u pamundësua.



## MUZETË DHE PARQET ARKEOLOGJIKE NË SHQIPËRI

Shqipëria numëron një numër të konsiderueshëm të muzeve dhe parqeve arkeologjike. Sipas të dhënave nga Ministria e Kulturës vendi ynë ka 15 muze. Të gjitha këto të shpërndara në të gjithë vendin dhe të aksesueshme për publikun.

Nr.	Emërtimi	Vendodhja
1.	Muzeu Historik Kombëtar	Tiranë
2.	Muzeu Kombëtar "Gjethi"	Tiranë
3.	Galeria Kombëtare e Arteve	Tiranë
4.	Muzeu Kombëtar Arkeologjik	Durrës
5.	Muzeu Kombëtar "Gj. K. Skënderbeu"	Krujë
6.	Muzeu Kombëtar Etnografik	Krujë
7.	Muzeu Kombëtar Ikonografik "Onufri"	Berat
8.	Muzeu Kombëtar Etnografik	Berat
9.	Muzeu Kombëtar i Pavarësisë	Vlorë
10.	Muzeu Kombëtar i Fotografisë "Marubi"	Shkodër
11.	Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar	Korçë
12.	Muzeu Qendror i Arsimit	Korçë
13.	Muzeu Arkeologjik	Korçë
14.	Muzeu Arkeologjik Butrint	Butrint
15.	Muzeu Arkeologjik Apoloni	Apoloni



Sa i përket parqeve arkeologjike, vendi ynë numëron nëntë prej tyre.

Nr.	Emërtimi	Vendodhja
1	Parku Kombëtar Butrint	Butrint, Sarandë
2	Parku Arkeologjik Apoloni	Apoloni, Fier
3	Parku Arkeologjik Bylis	Bylis, Mallakastër
4	Parku Arkeologjik Shkodër	Shkodër
5	Parku Arkeologjik Lezhë	Lezhë
6	Parku Arkeologjik Amantia	Vlorë
7	Parku Arkeologjik Orikum	Vlorë
8	Parku Arkeologjik Finiq	Finiq, Sarandë
9	Parku Arkeologjik Antigone	Gjirokastër

## ULJE E VIZITORËVE NË MUZE DHE PARQE ARKEOLOGJIKE PËR SHKAK TË PANDEMISË COVID-19

Pandemia ndikoi kështu në uljen drastike të vizitorëve në dy vitet e fundit, krahasuar kjo me periudhën para saj. Ministria e Kulturës për të ndihmuar në gjallërimin e muzeve dhe parqeve arkeologjike ndërmori nismën e të "dielave falas", ku hyrja për të vizituar këto vende të kulturës dhe trashëgimisë ishte falas çdo të dielë të fundit të muajit.

Megjithatë, kjo iniciativë nuk ka qenë mjaftueshëm për të bindur dhe ftuar qytetarët për të vizituar vendodhjet




historike dhe të trashëgimisë. Numri i vizitave sërish rezulton të jetë i ulët krahasuar me dy vite më herët.

Sipas të dhënave të Institutit të Statistikave <sup>1</sup>(INSTAT), nëse do të krahasojmë vizitorët e vitit 2020 me shifrën e vizitorëve të vitit 2019, vihet re se ka një rënie të ndjeshme të tyre.

Përkatësisht në kategorinë **muze**, numri i vizitorëve për vitin **2019** rezulton në **317.826** prej të cilëve 176.497 janë vizitorë të huaj.


Ndërsa për vitin **2020** numri i vizitorëve në muze është **49.288** prej të cilëve 9.963 janë të huaj.




Numri i vizitorëve në **kala** apo monumente të tjera për **vitin 2019** rezulton të jetë **322.395**, prej të cilëve 180.462 janë vizitorë të huaj. Për vitin **2020**, kjo shifër zbritet në **62.627** vizitorë, nga të cilët 13.757 janë të huaj.

<sup>1</sup> [statistika-te-kultures-2020.pdf](#)





Sa i përket **parqeve arkeologjike**, për vitin **2019** ishin gjithsej **424.860** vizitorë, prej të cilëve 228.391 ishin vizitorë të huaj. Ndërsa për vitin **2020** ky numër zbrit në **78.552** vizitorë, prej të cilëve 8.234 ishin të huaj.




Lidhur me të dhënat për vitin <sup>2</sup>2021, përmes një kërkesë për informacion Ministria e Kulturës vendosi në dispozicion vizitorët përgjatë muajve qershor-shtator 2021.

Vizitorët përgjatë muajve **qershor-shtator 2021** në **muze** kanë shënuar shifrën **76.398**. Të dhënat e vizitorëve për **pesë kalatë** në vend sikurse ajo e Beratit,

<sup>2</sup> Të dhëna të marra nga Ministria e Kulturës përmes kërkesës për informacion

Gjirokastrës, Porto Palermos, Kaninës dhe e Himarës përgjatë katër muajve shkon në **99.421**. Ndërsa numri i vizitorëve për **nëntë parqet arkeologjike** shkon në **98.796**.

Të llogaritura të gjithë së bashku, përgjatë periudhës qershor-shtator 2021 në 12 muze, pesë kala dhe 9 parqe arkeologjike ka pasur **274.615 vizitorë**.



## “TË PAIDENTIFIKUARIT” DHE DËMTIMET E KALAVE DHE PARQEVË ARKEOLOGJIKE

Në përfundim të muajit prill 2020 kalaja e Shkodrës fiku dritat përfundimisht si pasojë e vjedhjes së sistemit të ndriçimit. Persona të pa identifikuar vodhën sistemin e ndriçimit gjatë natës, fill pas ndriçimit total të saj pak muaj me hërët.

*3“Përtej dëmit ekonomik, ky është një cënim i rëndë i imazhit të siteve tona, trashëgimisë tonë kulturore në sytë e vizitorëve dhe bie ndesh me përpjekjet tona të përbashkëta për rikthimin në normalitet të sezonit turistik, goditur rëndë nga pandemia globale”, - u shpreh Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore në Shkodër.*



Situatë e njëjtë kjo e përsëritur edhe më herët në kala të tjera të vendit. Një vit më parë, teksa vendi ndodhej nën masat e rrepta të lëvizjes së lirë për shkak të pandemisë COVID-19, të njëjtin fat pësoi edhe kalaja e Lezhës. <sup>4</sup>Dëmtimi elektrik dhe vjedhja në mënyrë të vazhdueshme e ndriçuesve dhe prozhektorëve, bëri që kalaja të mos shquhej më përtej rrugës sikurse ndodhte më herët.

<sup>3</sup> <https://newsbomb.al/kalaja-e-rozafes-shkodranet-vjedhin-naten-ndricimin-vezullonte-para-dy-ditesh-sot-ne-gjendje-te-mjerueshme-fotot/>

<sup>4</sup> <https://abcnews.al/kalaja-e-lezhes-pa-vetem-2-vite-drite-hajdutet-e-lane-ne-terr-institucionet-smerrren-vesh-per-ndricimin/>



Më herët gjatë muajit prill të vitit 2020 u bë publik edhe dëmtimi i dy kolonave në monumentin Nymfeu në Parkun Arkeologjik Apoloni.



*<sup>5</sup>“Nga kolona e parë në anën veriore është rrëzuar pjesa e sipërme e cila është thyer në një prej thyerjeve të vjetra e cila ishte restauruar. Pjesa e kolonës dhe kapiteli kanë pësuar dëmtime të reja nga rrëzimi. Kolona e dytë është rrëzuar bazamenti dhe është ndarë në tre pjesë: pjesa e tamburit të poshtëm dhe një ndarje në një thyerje të vjetër e restauruar më parë. Kapiteli ishte rrezuar më larg kolonës dhe të gjitha pjesët e saj kishin ëpsuar dëmtime të reja me fragmentime dhe ciflosje nga përplasja me shkallët e monumentit. Shkallët e monumentit kanë pësuar ciflosje dhe fragmentime nga kolonat e rrëzuara”, -thuhet në shpjegimin shoqëruar relacionit të mbajtur gjatë konstatimit në terren.*

### **Edhe ky dëmtim erdhi nga persona të paidentifikuar.**

Më 27 korrik të vitit 2021 Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Korcë kallëzoi në Komisaratin e Policisë së Korcës vjedhjen e veprave të kulturës.

*<sup>6</sup>“Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Korcë ju bën me dije se është vënë në posedim të një materiali filmik dërguar nga ana e një banori të zonës së Voskopojës ku në pamjet filmike shihet një person i pa identifikuar, i cili*

---

<sup>5</sup> Të dhëna të marra nga Ministria e Kulturës përmes kërkesës për informacion

<sup>6</sup> Të dhëna të marra nga Ministria e Kulturës përmes kërkesës për informacion

*gërmon në ambientet e Kishës së Shën Mërisë, Voskolpojë, monument kulture i kategorisë së I-rë”, -thuhet në kallëzimin penal drejtuar policisë Korçë.*

Edhe në këtë rast personi është i paidentifikuar dhe për më tepër provat vijnë nga banorë të zonës.

Më 22 qershor 2021, sërisht Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore e korçës kallëzon në Komisarlatin e Policisë një tjetër dëmtim, kësaj radhe në Kishën e Shën Mëhillit, në Voskopojë.

*7“Ju informojmë se personat e pa identifikuar kanë thyer derën e jashtme të Kishës së Shën Mëhillit në Voskopojë dhe më pas kanë dëmtuar objektet e ndryshme që ndodhen në ambientet e brendshme të kishës, të cilat përdoren nga besimtarët gjatë ceremonive të ndryshme fetare”, -thuhet në kallëzimin penal.*

Kisha gëzon statusin monument kulture i kategorisë së I-rë.

Në po të njëjtin qark, atë të Korçës, vite më herët janë bërë të tjera kallëzime, kryesisht në vitin 2018, janë vënë re gërmime ilegale në kalanë e Bellodovës; dëmtimi i Urës së Nicës në Pogradec përmes gërmimeve në pjesën e strukturës së saj; dëmtimi i varreve të Selcës në Pogradec; ndërtime të paligjshme në territorin e varreve të Selcës në Pogradec; dëmtime përmes gërmimeve në pjesën shkëmbore të Gradishtës si dhe dëmtim të ikonostasit të Kishës së Shën Marisë në Lashovë, Leskovik.

---

<sup>7</sup> Të dhëna të marra nga Ministria e Kulturës përmes kërkesës për informacion

## SI MBROHEN KALATË, MUZETË DHE PARQET ARKEOLOGJIKE NË SHQIPËRI?

Referuar të dhënave të Ministrisë së Kulturës, institucionet e kulturës, duke përfshirë këtu muzetë, parqet arkeologjike apo kalatë ruhen nga kompani private të kontraktuara nga Drejtoritë Rajonale.

Përkatësisht, kompanitë që janë të përfshira në ruajtjen e tyre janë:

- a) DANI Security
- b) "Illyrian Guard"
- c) "TREZHNJEVA" sh.p.k.
- d) "Mandy 2K"
- e) "F.P.M"
- f) "NAZERI 2000"
- g) "ELEKTRO SECURITY ALBANIA"
- h) "Azizolli"

Nëse do të analizojmë mënyrën se si ruhen secila prej kalave, muzeve apo parqeve arkeologjike në vend, do të shohim se jo të gjitha prej tyre ruhen përmes kompanive private të sigurisë apo rojeve dhe sistemeve të kamerave, duke i lënë më të ekspozuara ndaj rrezikut për tu dëmtuar dhe vjedhur, sikurse kemi parashtruar edhe më sipër.

Edhe në rastet kur ka system monitorimi përmes kamerave, ato janë të vendosura përkatësisht pranë qendrave të biletarisë më së shumti apo zyrave të Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore.

### Specifikojmë ruajtjen e secilit objekt<sup>8</sup>:

- **Kalaja e Beratit:** Prej tre vitesh ruhet përmes kamerave nga kompania "Azizolli" me kontratë 1 vjecare. Kamerat të fokusuar vetëm te zyrat e DRTK-së Berat, tek Fondi i Ikonave dhe biletaria elektronike, pasi kalaja është e banuar dhe nuk është i mundur siguimi me kamera.

<sup>8</sup> Të dhëna të marra nga Ministria e Kulturës përmes kërkesës për informacion



- **Parku Arkeologjik Shkodër** ruhet nga “DANI Security”. Në këtë park ka vetëm shërbim kamerash në pikën e biletarisë elektronike.
- Në **Parkun Arkeologjik Lezhë** nuk ka shërbim të ruajtjes përmes rojeve fizike apo shërbim të ruajtjes me kamera sigurie, por vetëm biletashitës dhe punonjës mirëmbajtjeje.
- **Kalaja e Gjirokastrës** monitorohet dhe ruhet 24 orë me shërbim roje objekti, nga kompani “ILLYRIAN GUARD” sh.a. Aktualisht funksionon me një vendroje me tre roje. Hyrja e objektit monitorohet me kamera. Shërbimi i rojeve është i rregulluar me kontratë 1 vjeçare, e rinovueshme çdo vit.
- **Parku Arkeologjik Antigone/Adrianopol**, nuk ka shërbim me roje, si dhe nuk ka roje objekti nga stafi i DRTK Gjirokastrë. Sipas të dhënave të Ministrisë së Kulturës, gjatë orarit të punës punonjësit mundësojnë edhe ruajtjen e objektit.
- **Muzeu Historik Kombëtar** ka një kontratë aktive me shoqërinë “Illyrian Guard” SH.A dhe organizimi i shërbimit në objektin “Muzeu Historik Kombëtar” është me 1 vendroje me 3 turne nga e hëna në të dielë, dhe 1 vendroje, turni i dytë nga e mërkura në të dielë. Gjithashtu, Muzeu Historik Kombëtar ka sistem elektronik dhe kamera sigurie.
- **Qendra Muzore Durrës** ka dy objekte të rëndësishme, Muzeun Arkeologjik Durrës dhe Amfiteatrin Durrës, ruajta e të cilave sigurohet nga kompani sigurimi. QMD ka lidhur kontratë një vjeçare me “Illyrian Guard” sh.a. me një vendroje dhe tre turne. Gjithsej 4.98 punonjës shërbimi.
- **Qendra Muzeore Krujë** ka lidhur kontratë shërbimi vjetore me shoqërinë “Illyrian Guard” sh.a. Organizimi i shërbimit në Objektin Qendra Muzeore Kruje, është me një vendroje me tre turne me koeficient 4,98 roje.
- **Qendra Muzeore Berat** ka dy godina që ruhen me shoqëri private, me roje dhe sinjal alarmi.

- **Muzeu Ikonografi “Onufri** ka 4 roje dhe sinjal alarmi për tre turne në të gjitha ditët e javës, me kontratë njëvjeçare me kompaninë e sigurimit të ruajtjes së objekteve “Nazeri 2000”, që përfundon në 30 Nëntor 2021.
- **Muzeu Etnografik Berat** ka 4 roje dhe sinjal alarmi për tre turne në të gjitha ditët e javës, me kontratë njëvjeçare me kompaninë e sigurimit të ruajtjes së objekteve “Nazeri 2000”, që përfundon në 30 nëntor 2021.
- **Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe”**, nuk ka persona të angazhuar në pozicionin (roje, siguri), por është me kontratë shërbimi 1 vjeçare me shoqërinë "Illyrian Guard", e cila rinovohet çdo vit.
- **Muzeu Kombëtar i Pavarësisë, Vlorë** ka kontratë njëvjeçare sigurimi me kompaninë “F. P.M”, 1 roje sigurimi (turni i tretë) dhe monitorim me kamera 24 orë. Sipas përgjigjes së Ministrisë së Kulturës gjatë periudhës 2018 – 2021 nuk ka patur incidente me vizitorët dhe dëmtime të objekteve të ekspozuara.
- **Muzeu Kombëtar i Fotografisë Marubi “Shkodër”** aktualisht nuk ka të angazhuar asnjë roje. Siguria e muzeut kryhet përmes kamerave dhe sistemit të alarmit me kontratë vjetore me kompaninë e sigurimit “Dani Security”.
- **Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar, Arsimit Dhe Arkeologjik, Korçë,** e kryen sigurimin me anë të sistemit të kamerave, alarmin, mbrojtjen nga zjarri dhe grupi i gatshëm përmes kontratës vjetore me kompaninë “Elektro Security Albania”. Sipas të dhënave të Ministrisë së Kulturës, në këto muze gjatë periudhës 2018 – 2021 nuk ka pasur raste të dëmtimeve apo vjedhje të objekteve, si dhe incidente me vizitorët.
- **Parku Kombëtar Butrint** Siguria e zonës A3 që ka në administrim Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Kombëtar Butrint sigurohet nëpërmjet një kompanie private sigurimi “Mandi 2K”. Janë të angazhuar 13 roje sigurie, të ndarë në 2 vendroje me shërbim 24 orë (3 turne) dhe 3 vendoreje me shërbim 8 orë (1 turn). Ambientet e biletarisë dhe të kalasë së Akropolit monitorohen edhe me kamera

sigurie të cilat janë të aksesueshme si nga Ministria e Kulturës ashtu edhe nga kompania e sigurisë private.

- **Në Parkun Arkeologjik të Apolonisë** janë 2 vendroje me 5 roje secila. Ruajtja dhe siguria fizike e parkut dhe muzeut realizohet përmes kontraktimit të kompanive private për ruajtjen dhe sigurinë fizike, me kompaninë “Nazeri 2000”. Në sektorin e muzeut janë instaluar kamera në ambiente e brendshme dhe të jashtme.

## KLSH: PARQET ARKEOLOGJIKE NËN MUNGESËN E VËMENDJES NGA MINISTRIA E KULTURËS

Nga një auditim i kryer nga Konbtrulli i Lartë i Shtetit për periudhën 2016-2019 për institucionet që kanë nën menaxhim dhe ruajtje parqet arkeologjike përcaktohet vëmendja që këto parqe kanë pasur ndër vite në aspektin e menaxhimit si dhe të financimit.

Sipas 9relacionit që shoqëron auditimin, vihet re se buxheti i Ministrisë për parqet arkeologjike nuk ka qenë i qëndrueshëm, ashtu sikundër nuk ka pësuar rritje të konsiderueshme.

Viti/Buxheti	2016	2017	2018	2019
Buxheti total MKRS	1,699,187	1,900,895	2,257,486	2,128,700
Buxheti për sitet arkeologjike	180,459	189,240	198,077	217,550
<i>SA/Buxhetit MKRS</i>	<b>10.6 %</b>	<b>10 %</b>	<b>8.7 %</b>	<b>10.2%</b>

Burimi: MKRS; Përpunoi: Grupi i auditimit

Sipas tabelës së mësipërme të përpiluar nga KLSH vihet re se **fondet e planifikuar për parqet arkeologjike përgjatë periudhës 2016-2019 janë**

<sup>9</sup> <https://panel-klsh.almotech.co/storage/phpdBfAvh.pdf>



**shumë të ulëta**, parë kjo edhe në rëndësinë që ky sektor ka për promovimin e turizmit.

Ndërsa parë kjo në një prizëm më të gjerë sikurse buxheti i shtetit, hendeku i nivelit të financimit për parqet arkeologjike është edhe më i thellë.

Viti/Buxheti	2016	2017	2018	2019
Buxheti i Shtetit	264,141,978	283,299,687	306,174,422	308,078,194
Buxheti për sitet arkeol.	180,459	189,240	198,077	217,550
<i>SA/Buxhetit të Shtetit</i>	<i>0.7 %</i>	<i>0.67 %</i>	<i>0.64 %</i>	<i>0.7 %</i>

*Burimi: MKRS; Përpunoi: Grupi i auditimit*

Një tjetër shqetësim i ngritur nga Kontrolli i Lartë i Shtetit mes shumë të tjerash është edhe mënyra se si ruhen fizikisht parqet. Konkretisht, auditimi u krye në parqet arkeologjike Apoloni, Bylis, Orikum, Amantia dhe Butrint. Sipas relacionit, parku arkeologjik i Apolonisë ka rrethim dhe ndriçim të pjesshëm në zonat kryesore. *“Zonat e ndriçuara në park janë zona e manastirit dhe muzeu Arkeologjik, kurse pjesa tjetër është e pandricuar. Rrethimi gjithashtu është i pjesshëm në pjesën e zonës së Agoras dhe në disa monumente periferike me mozaik, kurse parku në tërësi nuk është i rrethuar, sepse ka një sipërfaqe relativisht të madhe rreth 700 ha”*, -thuhet në relacionit e KLSH-së.

Sipas KLSH-së për shkak të ngjarjeve të fundit sikurse dëmtimet ilegale, **shihet se ruajtja fizike nuk është e mjaftueshme për të parandaluar.**

*“Parku arkeologjik Bylis i administruar nga ZAKPA Fier është pjesërisht i rrethuar në zonën A, por në park nuk ka fare ndriçim dhe as roje. Parku së fundmi është rrezikuar nga zjarri. Ruajtja fizike në parqet arkeologjike të Amantias dhe Orikumit gjatë orarit zyrtar të punës realizohet nëpërmjet punonjësve të mirëmbajtjes së D.R.T.K-Vlorë, ndërsa për oraret e pas punës dhe në orët e natës nuk ka roje”*, -citohet në relacion.

Në parqet arkeologjike Amantia dhe Orikum nuk ka system ndricimi. Si rrjedhojë, nga KLSH vihet re se strukturat nuk janë të mjaftueshme për të kryer funksionin e ruajtjes së parqeve fizikisht. Kështu, përveç Parkut Arkeologjik të Apolonisë dhe Butrintit që ruhen me roje private, parqet si Bylis, Amantia dhe Orikum nuk kanë asnjë punonjës që të kryejë ruajtjen e tyre.

## Gjetjet kryesore:



Shqipëria gëzon një numër të larmishëm të muzeve, parqeve arkeologjike dhe kalave. Për shkak të pandemisë COVID-19 **veprimtaria e këtyre organizmave u paralizua.**



Numri i vizitorëve në dy vitet e fundit pësoi një rënie të konsiderueshme për shkak të pandemisë. Ministria e Kulturës përpos të “dielës së fundit të muajit falas” për biletat, nuk ka ndërmarrë asnjë fushatë që të promovojë muzetë, parqet arkeologjike dhe kalatë. Qoftë kjo fushatë në mediat tradicionale, ashtu sikurse edhe në mediat e reja online.




Përgjatë pandemisë, por si një vijimësi edhe e ngjarjeve të mëhershme, parqet arkeologjike, kalatë dhe monumentet e kulturës pjesë përbërëse e tyre, janë dëmtuar përmes gërmimeve ilegale dhe vjedhjes së sistemit të ndriçimit. Megjithëse raste të përsëritura, Ministria e Kulturës dhe institucionet nën të nuk kanë ndërmarrë masa për të shtuar sigurinë dhe ruajtjen e këtyre pasurive.



Kalatë, muzetë dhe parqet arkeologjike në Shqipëri ruhen dhe mbrohen përmes vendosjes së sistemit të kamerave dhe ruajtjes fizike nëpërmjet rojeve.



Jo të gjitha këto entitete gëzojnë ruajtje. Një pjesë e tyre janë të ekspozuara ndaj rrezikut për t'u dëmtuar dhe për t'u vjedhur. Roje të pakta, sistem kamerash i orientuar kryesisht drejt sportelit të biletarisë dhe zyrave të drejtorive sesa drejt objekteve me vlerë apo ato arkeologjike, janë disa realitete të pranishme në këtë sferë.



Sipas një auditimi të Kontrollit të Lartë të Shtetit, buxheti i akorduar për parqet arkeologjike është jo i qëndrueshëm dhe nuk ka pësuar rritje të konsiderueshme ndër vite, duke mos qenë në vëmendje të politikave të Ministrisë së Kulturës

## Rekomandime:

- Ministria e Kulturës duhet të mobilizohet dhe të ndërmarrë fushata promovuese të parqeve arkeologjike, muzeve dhe kalave në vend si dhe të informojë për rëndësinë dhe pasuritë arkeologjike dhe kulturore që ka vendi ynë duke shfrytëzuar mediat tradicionale dhe ato online.
- Ruajtja, mirëmbajtja dhe parandalimi i dëmtimeve të këtyre siteve duhet të kthehet në një gjendje prioritare dhe alerte duke marrë shkas ngjarjet e viteve të fundit.
- Në buxhetin e Ministrisë së Kulturës, por edhe në atë të shtetit, trashëgimia dhe kultura duhet të marrë një zë më të madh se sa ka qenë në këto vite.
- Të implementohen mënyra më të mira për të kryer ruajtjen fizike të çdo siti apo pasurie arkeologjike. Në rastet kur këto parqe janë në hapësira të konsiderueshme, të kryhet mbikqyrja e tyre përmes instalimit të kamerave të shpërndara në pikat më të volitshme dhe të monitorohen 24 orë për çdo situatë zjarri apo dëmtimi të paligjshëm.



# #QËNDRESË/MIRËQEVERISJE

QENDRESA  
QYTETARE



[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)

RAPORT MONITORIMI  
Kultura  
Gusht-Tetor 2021